

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “AMH-YLL” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 07.05.2024,unë i poshtëshënuari; MUHAMMAD ARHAM, i datëlindjes 27.12.1996, lindur ne Moradabad,Uttar,Pradesh, Indi,identifikuar me dokument identifikimi,pasaporte, me numër,N8577793,banues ne Tiraneme cilësinë e “ortakut themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “AMH-YLL” shpk.

Neni 1.

Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin“ AMH-YLL”shpk, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3

Selia

Shoqëria “AMH-YLL” shpk e ka seline në adresë:Rruga Lerton Vathi, Njesia Nr 11, Ndertese private me numer 61,Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise për shoqërine “AMH-YLL” shpk është: Import eksport, tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial.Shitje online te artikujve.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(një) kuote te cilat zotërohet si më poshtë:

Arham

MUHAMMAD ARHAM, i datëlindjes 27.12.1996, lindur ne Moradabad,Uttar,Pradesh,Indi banues ne Tirane ,identifikuar me dokument identifikimi ,pasaporte, me numër, N8577793, zotëron një kuotë ose 100 % të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

Arham

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë “AMH-YLL” shpk është: MUHAMMAD ARHAM i datelindjes 27.12.1996,. Identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti me numër personal, N8577793.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit të tij përkon me datën e themelimit të shoqërisë që është data 07.05.2024.

Afati i emerimit të administratorit është deri me 07.05.2029.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare “AMH-YLL” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

MUHAMMAD ARHAM

Arham

Tiranë, më datë 07.05.2024